



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0225

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Batisha Ibrahim Anëtare dhe Vedat Poterqoi Anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Security Code”, si dhe OE “BESA SECURITY” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të “QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objekteve brenda-QKUK-së” me numër të prokurimit 701-25-1774-2-1-5, me 22/05/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohen, si të bazuar ankesat e OE “Security Code”, me nr. 2025/0225, e datës 03/04/2025 si dhe OE “BESA SECURITY” SH.P.K. me nr. 2025/0230, e datës 04/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objekteve brenda-QKUK-së” me numër të prokurimit 701-25-1774-2-1-5, I inicuar nga AK “QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS”, **ndersa kontrata e nënshkruar nga AK të shfuqizohet.**

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Security Code”, si dhe “BESA SECURITY” SH.P.K.

4. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues pjesërisht aprovohen, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Me 20.03.2025, “QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për dhënie B08 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi Fizik i Objekteve brenda-QKUK-së” me numër të prokurimit 701-25-1774-2-1-5.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, lloji i kontrates shërbim, vlera e parashikuar e kontratë 1,050.000€.

Me 24.03.2025 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për dhënie të kontratës. OE “SKYFTERAT – LIVE” SH.P.K

Me 21.03.2025, OE “Security Code”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 24.03.2025 po ashtu edhe OE “BESA SECURITY” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 24.03.2025, dhe me datën 25.03.2025 Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e të dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 03.04.2025, OE “Security Code”, ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0225/2025 ndërsa me datë 04.04.2025 OE “BESA SECURITY” SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0230/2025.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0225/25 dhe ankesa nr. 0230/25 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Security Code”, janë parashtruar si në vijim:

Në kuptim të Neni 7 LPP-se Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafi Bazuar nëkërkesat e DT : Kërkesa –Aneksi 1 specifikimet teknike të detyrueshme.

AK nder tjera ka kërkuar 1. Kompensimin e të ardhurave mujore (paga) në vlerë jo me të ultet se 402.00 euro bruto në muaj dhe të paguaj të gjitha kontributet për punëtorë sipas Ligjit të punës nr. 03/L-212

Vërejtje: Duke marr parasysh rendësin e objekteve që duhet të ruhen si dhe nivelin e stafit dhe motivimit të tyre çështja e pagave të rojeve fizike është e një rëndësie të veçantë për autoritetin kontraktues

Paga 402 euro bruto bazë për rojë fizike të angazhuar në këtë kontratë duhet të jetë jo me pak së 402 €/muaj. Kontraktori është i obliguar që të respektoj ligjin e punës nr. 03/L-212 Udhëzimin administrativ të MPMS Nr. 09/2017 dhe të paguaj shtesë mbi pagën Bruto bazë për orët e nates dhe festa.

Shkelja nr.1AK në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar kundërshtim me DT , sepse duke shpallur fitues OE Skyfterat -Live SHPK me qmimin 748,047.92€ , nuk ka asnjë logjike të menduarit dhe asnjë mundësi argumentimi se ky OE mund të respektoj pagën baze bruto 402.00€ si e DT.

AK nuk ka promovuar transparenc dhe barazi , sepse komisioni gjatë fazës së negociatave , ka krijuar pyetje tendencioze , duke na pyetur dhe konstatuar nësi OE nëfazën e negocimit , se jemi të interesuar vetëm çmimin me të ulët , gjë që konsiderojmë që qysh nga fillimi i procesit , komisioni dhe personat përgjegjës , përmes formave të ndryshme kanë diskriminuar OE ofertues , në përfitim të kontratës Për OE nëfjale.

Diskrepanca nëqimin e ofertuar nga OE Skyfterat -Live SHPK që me datë 19.03.2025 sipas procesverbalit të hapjes ka ofertuar nëvlere mbi buxhetin e parashikuar, nëvlere 1,054,161.48€, ndërsa nënegocim me pyetje tendencioze nga komisioni, ky OE ka ofertuar nëvlere diferenca nëqimim - 306, 113.56€.

Nësi OE pjesëmarrës dyshojmë që OE i shpallur fitues , ka pasur informacionëlidhur me mënyrën se si AK do ta shpërblej me kontratë.

AK dhe komisioni ka shpallur fitues oferten që është dashur të shpallet e pa përgjegjshme sepse nuk mbulon pagën 402.00€.

Prandaj AK me vetdije ka diskriminuar konkurrentet në këtë aktivitet dhe ka Shkel ligjin Neni 7 LPP,,se Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

Shkelja nr.2Ak sipas kërkesave nëDT nëAneksin I specifikimet teknike të detyrueshme ka kërkuar që "Paga 402 euro bruto bazë për rojë fizike të angazhuar në këtë kontratë duhet të jetë jo me pak së 402 €/muaj.

Kontraktori është i obliguar që të respektoj ligjin e punës nr. 03/L-212, Udhëzimin administrativ të MPMS Nr. 09/2017 dhe të paguaj shtesë mbi pagën Bruto bazë për orët e nates dhe festa" ,prandaj AK I shpallur fitues OE Skyfterat live shpk, sipas qmimit të ofertuar nënegocim ka ofertë me çmimin për njësi orë punë 2.48 € , ndërsa nëanalizen financiare që ka ngarkuar nëDT ka oferten çmimi për njësi orë punë 3.49€.

Sipas ofertes se shpallur fitues AK ka shpërblje me kontratë oferten e cila nuk mbulon pagat shih tabelën nëvijim:

TABELA I -ÇMIMI I CILI ISHTË DASHUR TË TRAJTOHET SI PRAG MINIMAL

TABELA 2-ÇMIMI SIPAS OFERTES FITUESE DUKE SHKELUR TË GJITHA LIGJET E APLIKUESHME NËKOSOVË

Sipas kërkesave të dt , secili oe qe ka ofeftuar çmimin per njësi orë punë me të vogël se 3.27€, është i pa përgjegjshëm. Prove -analiza e " SKYFTERAT - LIVE " SH.P.K.: nëkundërshtim me çmimin e negociuar 2,48€ për një orë punë ,AK dhe komisioni vlerësues po vepron nëkundërshtim me Neni 27 Dosja e Tenderit. Duke vlerësuar oferten qe shkel ligjin e punës nr 03/L-212 nenin 56 i këtij ligji dhe udhëzimin administrative Për fondin e orëve 176 ore nëmuaj.

Shkelja nr.3AK po ashtu është nëkundërshtim me Neni 28 LPP-se - Specifikimet teknike sepse kërkesat e DT aneksi I Specifikimet teknike të detyrueshme po shkelen me veprimin për shpërblimin e OE fitues i cili është i pa përgjegjshëm nuk përmbush kërkesën e pagës 402.00€ bruto baze dhe kërkesat e ligjit të punës siq janë kërkuar nëaneksin I.

Neni 31Ekzekutimi i kontratave

1.Autoritetet kontraktuese mund të vendosin kërkesa të veçanta në lidhje me mënyrën se si kontrata duhet të ekzekutohet, me kusht që kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit 7 dhe janë paraqitur në dosjen e tenderit. Kërkesat e tilla në lidhje me ekzekutimin e një kontratë kanë qëllim të sigurojnë një nivel të caktuar të kushteve të punës ose të mbrojtjes së mjedisit.

2. Autoritetet Kontraktuese mund të referohen në kushtet e performancës së kontrates në veçanti atyre të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e punëtorëve dhe kushteve të punës të cilat janë në fuqi me ligj apo rregullore në Kosovë, me kusht që këto kushtë të përshihen në shpalljen e kontrates dhe në specifikimet teknike.

3. Një Autoritet Kontraktues mund të theksoi në dokumentacionin e kontrates organin apo organet nga të cilat një kandidat apo tenderues mund të marrë informatat e duhura për obligimet që kanë të bëjnë me tatimet, mbrojtjen e mjedisit, dispozitave të mbrojtjes së punëtorëve dhe për kushtet të cilat janë në fuqi me ligj apo rregullore në Kosovë.

Shkelja nr.4Duke vepruar me shpërblimin me kontratë për OE qe nuk respekton ligjin e punës dhe kjo kontratë rezulton nëdem të punëtorëve , AK po Shkel nenin 31 të LPP-se

Bazuar në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) ,AK ka kërkuar kriter qe të shperblehet me kontratë AK- Tenderi i përgjegjshëm me Cmimin më të ulët

Shkelja nr.5Duke vepruar me shpërblimin me kontratë OE qe nuk respekton ligjin e punës dhe kjo kontratë rezulton në dem të punëtorëve , AK ka shkelur Neni 52 Njoftimi i kriterëve Për dhënien e kontrates

Shkelja nr.4Duke vepruar me shpërblimin me kontratë për OE qe nuk respekton ligjin e punës dhe kjo kontratë rezulton nëdem të punëtorëve , AK po Shkel nenin 31 të LPP-se

Bazuar nëSeksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) ,AK ka kërkuar kriter qe të shperblehet me kontratë AK- Tenderi i përgjegjshëm me Cmimin më të ulët

Shkelja nr.5Duke vepruar me shpërblimin me kontratë OE qe nuk respekton ligjin e punës dhe kjo kontratë rezulton në dem të punëtorëve , AK ka shkelur Neni 52 Njoftimi i kriterëve Për

dhënien e kontrates

Shkelja nr.6AK ka vepruar nëkundërshtim me Ligjin për prokurim public me nenin Neni 108/A

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve , sepse nuk ka pezulluar aktivitetin nëmomentin kur ka pranuar kërkesa për rishqyrtim siq parashihet nëparagrafin 2 citoi "Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkates kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar"

Po ashtu AK ka shkelur edhe nenin Neni 109 Afatet për Dorëzimin e Ankesës, sepse duke mos respektuar paragrafin 2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) diteve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji, AK ka vendosur të nënshkruaj kontratë pa përfunduar procedurat e ankesave siq parashihet në ligj

AK QKUK dhe komisioni vlerësues , kanë shkelur ligjin dhe duke u thirrë nëprocedure emergjentë me dashje kanë shkelur të gjitha kriteret dhe kërkesat e DT dhe nëkundërshtim me Ligjin per prokurim publik , kanë vendosur , me ngutje nëketë aktivitet të prokurimit. Në ç’do faze të trajtimit të ankesave përgjigja e komisionit gjatë negocimit dhe nëankesa standarde ka qenëprocedure emergjente.

Dëmet materialePërshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet ti shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Neve si Operator Ekonomik na kërcënohet të na shkaktojnë dëme materiale në v/erë të madhe, prandaj kerkojme nga OSHP qe argumentet dhe shkeljet sipas Ligjit qe AK i ka shkaktuar të nxjerre vendim ,qe lenda të kthehet nëriv/eresim dhe nësi OE me oferten sipas kriterit tenderi i pergjegjshem me çmimin me të lire , tejemifitues nëketë aktivitet.

AK QKUK dhe komisioni vlerësues , kanë shkelur ligjin dhe duke u thirrë nëprocedure emergjentë me dashje kanë shkelur të gjitha kriteret dhe kërkesat e DT dhe nëkundërshtim me Ligjin per prokurim publik , kanë vendosur , me ngutje nëketë aktivitet të prokurimit. Nëç’do faze të trajtimit të ankesave përgjigja e komisionit gjatë negocimit dhe nëankesa standarde ka qenëprocedure emergjente.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE “Security Code”, konsideron se AK ka shkelur Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, paragrafi 6, Neni 27 Dosja e Tenderit, Neni 28 LPP-se –Specifikimet teknike, Neni 31 Ekzekutimi i kontratave, Neni 51 Njoftimii i kriterëve të për zgjedhjeve, Neni 52 Njoftimi i Kriterëve të dhënjës, Neni 56 Dispozitat e Përgjithhme mbi Përzgjedhjen e Pjesemaresve dhe Dhënien e Kontratave paragrafi2, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve, Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “Security Code”, Refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pabazuar Arsytet : Lidhur me tenderin për: ”Sigurimi Fizik i Objekteve brenda-QKUK-së” me numër identifikues: 701-25- 1774-2-1-5, numri i brendshëm: 701-25-047-215, AK-QKUK kapranuar një kërkesë për rishqyrtim me pretendimet si ne vijim:

Pretendimi ankimore për shkelje te dispozitave te LPP-së:

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminim

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencë

Neni 35 Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës

Neni 41 Njoftimi mbi Dhënien e Kontratës.

Neni 50 Dërgimi dhe Përmbajtja e Ftesave për Tenderi Kritereve të Përzgjedhjesi kritereve për dhënien e kontratësi informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesiti Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar

Neni 58 Hapja e Tenderëve Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës Aneksi 1. Tek specifikimet teknike të detyrueshme pika 9.2 Evidenca 2. Ofertuesi duhet të japë një deklaratë me shkrim se kompensimi i të ardhurave mujore (Paga bruto bazë) për punëtorë do të jetë 402 € .

Përgjigje ne pretendimet ankimore:

- AK-QKUK e konsideron si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim për faktin se oferta e rekomanduar për kontratë është me çmimin me të lirë.

- Operatorit Ekonomik të cilit iu ka dhënë Kontrata ka Deklaratë të nënshkruar dhe të vëltosur lidhur me pagën bazë , njëjtë është deklaruar edhe para komisionit që ka zhvilluar Negociatat.

Për shkak të emergjencave të krijuara dhe afatëve kohorë të limituara Autoriteti Kontraktues nuk është lëshuar në Analizë Financiare. Prandaj bazuar në atë që u tha me lartë, AK-QKUK e konsideron të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BESA SECURITY” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Meqenëse është përdorë procedura e negociuar pa publik të njoftimit për kontratë, me datë 24.03.2025 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK. Nëpërputhje me nenin 108/a të LPP kemi parashtruar Kërkesë për rishqyrtim brenda afatëve kohorë, respektivisht me datë 24.03.2025 dhe plotësim të kërkesës për rishqyrtim me datë 25.03.2025. Po të njëjten ditë, me datë 25.03.2025 AK ka nxjerr Vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim.

1. Neni 1 dhe 35 i LPP, dhe neni 48 i Rregullores së Prokurimit Publik

Neni 1 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) përcakton se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një shfrytëzim sa më efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike

Në lidhje me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objekteve brenda QKUK-së”, Autoriteti Kontraktues (AK) ka zbatuar procedurën e negociuar pa publikim, duke u bazuar në arsyetimin e emergjencës. Sipas nenit 35.1 (iii) të LPP-së, përdorimi i kësaj procedure është i lejueshëm vetëm në rastë të caktuara, përfshirë rastet kur situata emergjentë ka ardhur si pasojë e ngjarjeve objektivisht të verifikueshme dhe të parashikueshme nga autoriteti kontraktues. Për më tepër, neni 35.1 (iiii) thekson se kjo dispozitë nuk mund të zbatohet nëse rrethanat emergjentë janë

rezultat i veprimeve neglizhente, të qëllimshme apo mosveprimeve të autoritetit kontraktues.

Në këtë kontekst, vendimi përfundimtar i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për anulimin e procedurës së hapur është marrë më 21.11.2024, ndërsa AK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim deri më 17.03.2025, duke lënë një periudhë prej kater muajsh pa reagim. Kjo vonesë mund të interpretohet si neglizhencë e AK-së, e cila ngre shqetesime në raport me respektimin e nenit 1 dhe nenit 35 të LPP-së, si dhe nenit 48 të Rregullores së Prokurimit Publik, i cili përcakton kushtet dhe rrethanat për përdorimin e procedurave emergjente, përfshirë:

- Domosdoshmërinë striktë për zhvillimin e një aktiviteti prokurimi në baza emergjente,
- Motivimin nga ngjarje objektivisht të verifikueshme, të cilat nuk kanë qenë të parashikueshme nga autoriteti kontraktues,
- Pamundësinë për të respektuar afatet kohore të përcaktuara për procedura të tjera, dhe
- Mospërfshirjen e veprimeve neglizhente, të qëllimshme apo mosveprimeve të autoritetit kontraktues si shkaktarë të situates emergjente.

Duke marrë parasysh se Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për një periudhë prej kater muajsh pas vendimit përfundimtar të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) më 21.11.2024, kjo situatë ngre shqetesime në lidhje me respektimin e kornizës ligjore për prokurimin publik dhe rezulton se vendimi për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim nuk përmbush kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke përbërë një shkelje të nenit 1 dhe nenit 35 të LPP-së, si dhe nenit 48 të Rregullores së Prokurimit Publik.

Në lidhje me publikimin e Njoftimit mbi Vendimin, vlen të theksohet se, ndonëse ky dokument është hartuar më 20.03.2025, ai është publikuar pas kater ditesh, më 24.03.2025. Kjo vonesë ngre pikëpyetje mbi natyrën emergjentë të aktivitetit të prokurimit, pasi nëse rasti do të ishte trajtuar si urgjent, pritej që publikimi të kryhej pa vonesa të panevojshme.

20.03.2025 ora 21 33 - B58 NJOFTIM

Gjithashtu, është evidentuar se QKUK ka publikuar dy Njoftime për Dhënie të Kontrates, një më 24.03.2025 dhe një tjetër më 25.03.2025. Në këtë kontekst, dallimi në vlerën e ofertes së operatorit ekonomik—ku në njoftimin e dates 24.03.2025 shënohet një shumë prej 748,047.92 euro, ndërsa në atë të dates 25.03.2025 vlera figuron si 743,047.92 euro—ngre shqetesime në lidhje me saktësinë dhe qëndrueshmërinë e të dhënave të publikuara.

Njoftime për dhënje të kontratës 25.03.2025 24.03.2025 00:00

Njoftime për dhënje të kontratës 24.03.2025 21.03.2025 00:00

Neni 50 i Rregullores Nr. Nr. 002/2024 për Plotesimin dhe Ndryshimin e
Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Në përputhje me nenin 50.3 të Rregullores së Prokurimit Publik, i gjithë procesi i vlerësimit dhe negociimit duhet të zhvillohet përmes platformës së prokurimit elektronik. Në rast specifike, negociimi mund të kryhet në formë fizike, me kusht që procesverbali i negociatave të ngarkohet

në platformë. AK nuk ka publikuar procesverbalin e negociatave.

Në këtë kontekst, vlen të theksohet se në aktivitetin e prokurimit për “Sigurimin e objekteve”, QKUK ka dorëzuar ftesën për negociata më 19.03.2025 dhe të njëjten ditë ka zhvilluar negociatat në formë fizike. Duke pasur parasysh se aktiviteti në fjalë nuk përbën një rast specifik që do të kërkontë zhvillimin e negocimit në këtë format dhe se elementi i vetëm i negociuar ka qenë çmimi, kjo situatë ngreh shqetesime në lidhje me përputhshmërinë e procesit me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin përkatës.

Ftese për negociata -Sigurimi fizik i objekte Gjithashtu, sipas nenit 50.8 të Rregullores së Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të sigurojë negociata me një numër të mjaftueshëm të operatorëve ekonomikë për të garantuar konkurrencë efektive, si dhe të sigurohet që procesi të jetë transparent dhe të dokumentohet saktë në të gjitha fazat për të ruajtur integritetin e tij. Në këtë rast, fakti që operatori ekonomik i cili fillimisht kishte ofertuar çmimin më të lartë përmes platformës elektronike e ka ulur çmimin për 300,000 euro pas negociatave fizike, ngre shqetesime lidhur me garantimin e konkurrencës dhe transparencës së procesit.

Rezultatet e procesverbalit të hapjesRezultatet pas negociimit

3. Neni 7 i LPP– Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi Në cilësinë e palës së interesuar, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim duke argumentuar se oferta e operatorit ekonomik të shpallur fitues përmban çmim anormalisht të ulët. Në përgjigje të këtij pretendimi, QKUK ka deklaruar se për shkak të emergjencës nuk është kryer analiza financiare e ofertes.

Kjo ngre një çështje të rëndësishme: nëse emergjenca është përdorur si argument për të mos kryer analizën financiare, atëherë cili ka qenë qëllimi i zhvillimit të negociatave? Në këtë kontekst, lind nevoja për të vlerësuar arsyetimin dhe koherencën e qasjes së ndjekur nga autoriteti kontraktues në këtë proces.

Për më tepër, ky veprim bie ndesh me parimin e barazisë në trajtim dhe mos-diskriminimit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i cili kërkon që autoriteti kontraktues të trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe të veprojë në mënyrë transparente.

Në përputhje me nenin 42 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe nenin 21.8 të Rregullores së Prokurimit Publik, autoriteti kontraktues është i detyruar të publikojë Njoftimin për Nënshkrimin e Kontrates brenda dy diteve nga data e nënshkrimit. Në këtë rast, kontrata është nënshkruar më 21.03.2025, ndërsa publikimi i Njoftimit për Nënshkrimin e Kontrates është bërë më 27.03.2025, duke tejkaluar afatin ligjor të përcaktuar. Ky vonim përbën shkelje të dispozitave përkatëse të LPP-së dhe Rregullores së Prokurimit Publik, të cilat kërkojnë që publikimi të bëhet brenda afateve të përcaktuara për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien në procesin e prokurimit.

Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se Njoftimi mbi Vendimin e AK është publikuar më 24.03.2025, tre ditë pas nënshkrimit të kontrates më 21.03.2025. Kjo vonesë ngre shqetesime në lidhje me respektimin e parimit të transparencës, si një nga shtyllat kryesore të një procesi të drejtë dhe të barabartë të prokurimit publik

Neni 59 i LPP – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Argumentimi i QKUK-së se për shkak të emergjencës nuk është kryer analiza financiare është në kundërshtim me nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Ky nen përcakton qartë se një tender mund të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Mospërfshirja e analizës financiare bie ndesh me këtë dispozitë ligjore, pasi nuk garanton që oferta e zgjedhur përmbush kriteret e kërkuara. Në veçanti:

- Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të sigurohet që çdo tender i përgjegjshëm përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, përfshirë analizën financiare
- Arsyeja për emergjencë nuk justifikon shmangien e një analize të tillë, pasi ligji nuk përjashton kërkesat themelore të vlerësimit edhe në rastet kur përdoret procedura e negociuar
- Mungesa e analizës financiare cenon parimin e barazisë në trajtim dhe ndikon në transparencën e procesit të prokurimit, duke krijuar mundësi për keqpërdorime ose trajtim preferencial

Për këto arsye, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59.4 të LPP dhe OSHP duhet të marrë masat e nevojshme për të adresuar këtë shkelje dhe për të garantuar një proces të drejtë dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë

2. BESA Vendim për Refuzim të Kërkesë

Me datën 20.03.2025 nëmbrëmje, në platformën e-prokurimi kemi pranuar Njoftimin mbi Vendimin e AK, ku AK e ka cilësuar si të suksesshëm pas negociatave OE Skyfterat, me çmim 748,047.92€.

Kërkesa nga AK është që paga baze të punëtor me orare të rregullt punëtë jetë minimalisht 402.00EUR bruto apo mesatarisht për një ore punë 2.28EUR.

Duke marrë këtë në konsideratë, dhe kërkesën nga AK që të ofrohet shërbimi për 50,342 ore punë në muaj apo 183,252 për gjashtë muaj, i bje që, oferta e konsiderura nga AK për kompaninë Skyfterat për shpërbllim me kontratë është e papërgjegjshme pasi që:

Përshkrimi Oferta

Përveç kësaj, deklarata që OE Skyfterat për pagën e punonjësve të cilën supozojmë që e kanë deponuar në këtë aktivitet, edhe po të mos ishte kriteri për pagën për punëtorin të ishte 402.00, por të mbetet në pragun e pagës minimale të përcaktuar në nivel vendi, i njëjti me ofertën e paraqitur nuk do të arrijë të përmbushë këtë kriter.

Pasi që paga minimale në nivel vendi është e caktuar me 350.00EUR në muaj apo 2.00 për një ore punëtë rregull (që me kontribut personal të punëdhënësit) e cila ngritet me minimalisht 5% dhe arrijë në 2.10EUR, nuk mjafton duke marrë në konsideratë detyrimet ligjore nga neni 56 i Ligjit Nr. 03/L-212 i të Punës, me të cilin përcaktohen përveç tjerave, shtesat për orë të nates +30% nga koeficienti i pagës bazë

Përshkrimi

Pa llogaritur asnjë shpenzim shtese qe është detyrim ligjore, me nje matematike të thjeshtë rezulton qe oferta e OE Skyfterat per këtë aktivitet duhet të shpallet e papergjegjshme.

Neni 59.4 i LPP-se nder të tjera thotë se: AK do të konsideroje nje tender të pergjegjshem vetem nese tenderi në fjale është nëpërputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara nënjoftimin e kontrates dhe nëdosjen e tenderit

Andaj, duke marre parasysh faktet dhe argumentet e mesiperme, qe të mos behet diskrimin dhe mos perfillje edhe e Nenit 7 – Barazia në Trajtim / Jo Diskiminimi, dhe duke u kujdesur qe të mos behen shkelje të Nenit 61 dhe Neni 59.4 të LPP-se, kerkojme nga ju qe të anuloni vendimin e publikuar me daten 20.03.2025 dhe të shperbleni me kontratë OE Besa Security si ofertues i pergjegjshem dhe me cmimin me të ulet në krahasim me ofertat tjera.

17.32. Në rast se çmimi i ofruar nga Ofertuesi nuk mbulon pagat minimale të punonjësve që do të përfshihen në ekzekutimin e kontrates, e rregulluar nga Ministritë në sektorë të ndryshëm, oferta mund të konsiderohet si ofertë jo-normalisht e ulët.

Gjatë përcaktimit të pagave minimale dhe pagave qe do tu paguhen të punësuarve, Autoritetet Kontraktuese dhe Ofertuesit duhet të respektojnë pagat minimale të kërkuara dhe taksat dhe kontributet sociale përkatëse të publikuara në sektorët përkatës.

Autoriteti kontraktues mund të kërkojë informacion lidhur me pagat minimale përkatëse të zbatueshme nga ana e Operatorit ekonomik gjatë vlerësimit të arsyeve të dorëzuara nga Operatorët ekonomik.

Pra, sic e kemi përshkruar me poshte, përveç se Skyfterat nuk e mbulojnë pagën e përcaktuar nga ju si AK në vlerë prej 402 Euro, ata nuk e mbulojnë as pagën minimale të përcaktuar me ligj, respektivisht 350 Euro

Neni 132 i LPP - Prokurimet e Mbyllura në Kundërshtim me Këtë Ligj

Neni 132 i LPP përcakton se “Kontrata publike ose konkursi i projektimit mund të shfuqizohen pjesërisht ose plotësisht nga OSHP ose një gjykatë, nëse të përmendurit konstatojnë se kontrata publike ose konkursi i projektimit:

1.1. është dhënë pa publikimin e mëhershëm të njoftimit kur është kërkuar nga ky ligj;

1.2. është përfunduar gjatë periudhës së pritjes sipas neni 26 të këtij ligji apo gjatë periudhës së vënies së ndonjë mase të përkohshme të urdhëruar nga OSHP ose një gjykatë që ndalon përmbylljen e kontrates

Autoriteti Kontraktues (AK), respektivisht QKUK, nuk ka publikuar Njoftimin për Kontratë në përputhje me kërkesat ligjore, duke pritur për një periudhë prej kater muajsh dhe duke e justifikuar këtë vonesë përmes përdorimit të procedurës së negociuar për shkak të emergjencës. Gjithashtu, ndonëse janë ftuar disa operatorë ekonomikë për negociata, AK nuk ka respektuar periudhën e pritjes për ankesa, duke vijuar me nënshkrimin e kontrates. Veprimet e QKUK përmbushin dy kushtet e nenit 132 të LPP.

- Neni 132.1.1: Mosrespektimi i kërkesës për publikimin e mëhershëm të njoftimit;

- Neni 132.1.2: Nënshkrimi i kontrates gjatë periudhës së pritjes.

Duke marrë parasysh këto shkelje, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që të shfuqizojë kontraten e nënshkruar në përputhje me nenin 132.2.1 të LPP-së.

Kërkojmë nga OSHP që të ketë parasysh Nenin 133 Deklaratat e jo-efektivitetit të LPP, i cili nen i jep kompetencë OSHP që të shfuqizojë kontraten publike dhe të shpall si joefektive, nëse konstatohet se kontrata publike përmbush kushtet e nenit 132 të LPP-se.

Gjithashtu, kërkojmë që OSHP të kërkojë nga Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP) marrjen e certifikates së Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit (ZPP), në përputhje me nenin 97 të Rregullores së Prokurimit Publik, pika "m", e cila përcakton si shkelje të rëndë nënshkrimin e një kontratë publike gjatë periudhës së pritjes, sipas nenit 26 të LPP-së.

Në këtë kontekst, konsiderojmë se veprimet e ndërmarra nga AK bien ndesh me parimet e transparencës dhe barazisë në trajtimin e operatorëve ekonomikë, duke cenuar integritetin e procesit të prokurimit publik.

Neni 42.2 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotesimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Në përputhje me nenin 42.2 të Rregullores së Prokurimit Publik, në procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, Autoriteti Kontraktues është i detyruar të publikojë njëkohësisht Formularin B58 – “Njoftimin mbi Vendimin e AK” dhe Formularin B08 – “Njoftimin për Dhënie të Kontrates”. Nga momenti i këtij publikimi, fillojnë afatet kohore për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave.

Në këtë rast, QKUK ka ngritur “Njoftimin mbi Vendimin e AK”, por ka vazhduar me nënshkrimin e kontrates pa pritur afatin ligjor për paraqitjen e ankesave. Kjo përbën shkelje të nenit 42.2 dhe cenon të drejtën e operatorëve ekonomikë dhe palëve të interesuara për të ushtruar mjetet e tyre ligjore për mbrojtjen e interesave të tyre.

Si rrjedhojë, kërkohet që OSHP të shqyrtojë këtë shkelje dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar respektimin e procedurave ligjore dhe integritetin e procesit të prokurimit

Neni 61.3 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotesimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Në përputhje me nenin 61.3 të Rregullores së Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktues, përkatesisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, është i detyruar të publikojë Kërkesën për Rishqyrtim në Platformën e Prokurimit Elektronik, tek dosja e tenderit në seksionin “shtu dokument shtesë”.

Në këtë rast, QKUK nuk ka përmbushur këtë detyrim ligjor, duke mos publikuar Kërkesën për Rishqyrtim. Kjo përbën shkelje të parimeve të transparencës dhe integritetit, pasi mungesa e publikimit pengon palët e interesuara të kenë qasje në informacionin e nevojshëm për të ndjekur procedurat ligjore dhe për të ushtruar të drejtat e tyre.

Si rrjedhojë, kërkohet që OSHP të konstatojë këtë shkelje dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar që Autoriteti Kontraktues të respektojë detyrimet ligjore dhe të garantojë një proces të drejtë dhe transparent të prokurimit.

2. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, nërast se përfshini pretendime për kompensim.

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke eliminuar padrejtesisht oferten tonë, gjë që ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta materiale, përfshirë:

- Kostot e përgatitjes së ofertes dhe dokumentacionit mbështetës; • Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontratë të mundshme;
- Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet.

Duke u bazuar në shkeljet e sipërpërmendura dhe dispozitat ligjore të LPP, kërkojmë nga OSHP:

1. Shfuqizimin e kontrates publike në përputhje me Nenin 132.2.1 të LPP;
2. Shpalljen e kontrates si joefektive, duke u mbështetur në Nenin 133 të LPP;
3. Kërkesën ndaj KRPP për marrjen e certifikates së Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, bazuar në Nenin 97, pika "m" e Rregullores së Prokurimit Publik
4. Obligimin e AK për rishikim të procesit të prokurimit, duke respektuar dispozitat ligjore dhe standardet e transparencës dhe barazisë.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, "BESA SECURITY" SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ftese për oferta – 17.03.2025, Afati për dorëzimin e ofertave: 18.03.2025 14:30, Ftese për negociata: 19.04.2025, Njoftimi mbi vendimin e AK: 24.03.2025, Njoftimi për dhënie të kontrates: 24.03.2025, Njoftimi për dhënie të kontrates 2: 25.04.2025, Kërkesa për rishqyrtim pranë AK: 24.03.2025, Plotesimi i kërkesës për rishqyrtim: 25.03.2025, Vendimi i AK mbi kërkesën për rishqyrtim: 25.03.2025, njoftimi për nënshkrim të kontrates: 27.03.2025.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për "BESA SECURITY" SH.P.K Refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pabazuar Arsytim: Lidhur me tenderin për: "Sigurimi Fizik i Objekteve brenda-QKUK-së" me numër identifikues: 701-25- 1774-2-1-5, numri i brendshëm: 701-25-047-215, AK-QKUK ka pranuar një kërkesë për rishqyrtim me pretendimet si ne vijim:

Pretendimi ankimorë kanë të bëjnë me: Aneksi 1. Tek specifikimet teknike të detyrueshme pika 9.2 Evidenca 2. Ofertuesi duhet të japë një deklaratë me shkrim se kompensimi i të ardhurave mujore (Pag bruto bazë) për punëtorë do të jetë 402 € .

Përgjigje ne pretendimet ankimore:

- AK-QKUK e konsideron si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim për faktin se oferta e rekomanduar për kontratë është me çmimin me të lirë.

•Operatorit Ekonomik te cilit iu ka dhënë Kontrata ka Deklaratë te nënshkruar dhe te vulosur lidhur me pagën bazë, njëjtë është deklaruar edhe para komisionit qe ka zhvilluar Negociatat. Për shkak te emergjencave te krijuara dhe afateve kohore te limituara Autoriteti Kontraktues nuk është lëshuar ne Analizë Financiare. Prandaj bazuar ne atë qe u tha me larte, AK-QKUK e konsideron te pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 10.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0225/2025 ndërsa me datë 15.04.2025 Paneli Shqyrtues ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0230/2025.

Lidhur me ankesën nr. 0225/25 me datë 28.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2025/0225 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa kontrata e nënshkruar nga AK të shfuqizohet.

Lidhur me ankesën nr. 0230/25 me datë 28.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me Nr. 2025/0230 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa kontrata e nënshkruar nga AK të shfuqizohet.

Raportin e ekspertizës me nr.0225/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk ka dhen pergjigje rreth raportit te ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0230/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës shqyrtuese, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Security Code”, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0225 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 1Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, paragrafi 6

Në lidhje me këtë nen Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në menyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit. Pretendimi i OE ankues rreth kritereve të vendosura në dosjen e tenderit dhe specifikimet teknike sipas Aneksit 1, bien në kundërshtim me qelimin e nenit 7 të LPP-së, pretendimi në lidhje me Diskrepanca nëqimin e ofertuar nga OE Skyfterat -Live SHPK që me datë 19.03.2025 sipas procesverbalit të hapjes ku OE fitues ka ofertuar nëvlerë mbi buxhetin e parashikuar, nëvlerë 1,054,161.48€ po ashtu edhe pretendimi se OE ankues ka dyshimeve së ka pasur informacionëlidhur me mënyrën se si AK do ta shpërblej me kontratë OE-fitues. Ekspertja shqyrtuese sqaron së OE Skyfterat -Live SHPK kanë ofruar çmimin me ofertë përmes E-prokurimit mbi vlerën e parashikuar. Vlera e parashikuar e kontrates: 1,050.000 €, Zotimi 1 mjeteve në vlerë 175,000.00 €, dhe çmimi pas negociatave për OE fitues është 24.03.2025 në dy Vendime të publikuar të AK-së. 748,047.92€ dhe 743,047.92€ dhe kjo ngrit shqetesime në lidhje me saktësinë dhe qëndrueshmërinë e të dhënave të publikuara në Vendimet e AK tek Operatorët ekonomik për me teper pasi ka qenë me Procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe nuk ka procesverbal të ngarkuar në Platforme elektronike pasi negociatat janë zhvilluar në menyrë fizike. Procesverbal i negociatave nuk është i ngarkuar në Platformen elektronike nuk ka informacionëbazuar në Procesverbalin e negociatave dhe nuk mund të jap mendimin tim profesional në lidhje me pyetjet dhe trajtimin nga ana e AK-QKUK përmes negociatave ngase edhe ju si OE nuk keni ofruar asnjë deshmi. Ekspertja sqaron se duke u bazuar nënenin 21.4 pika c dhe d -Njoftim mbi vendimin e AKc. Në rastin e vendimit për shpërblim të një kontratë duke përdorur Procedurën e Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontrate, ZPP do të përgatitë dhe publikoj në të njëjten kohë Njoftimin mbi Vendimin e AK (B58) dhe Njoftimin për dhënie të kontrates (B08), meqenëse B08 është njoftimi i parë i publikuar dhe i qasshëm nga palët e interesuara. d. Pas plotesimit të të dhënave në hapat përkates për “Dhënie të Kontrates” AK përkatesisht ZPP krijon njoftimin për dhënie të kontrates dhe para se ta dërgojë për publikim duhet t’a kontrolloj se të gjitha shënimet e vendosura janë të sakta. Ekspertja sqaron se AK –QKUK ka krijuar dyshime tek OE në rastin e publikimeve të dy Vendimeve të AK-së me çmime të ndryshme dhe dy Njoftime për dhënjë pas nënshkrimit të kontrates. Pavarësisht se Procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë konsiderohet ndër procedurat me jo transparentë nëpërdorimin e saj në krahasim me procedurat tjera dhe është në diskrecion të Autoriteteve kontaktues, plotesimi i kushteve për përdorimin e kesaj procedure dhe trajtimi i barabartë duhet të respektohet në të gjitha fazat e prokurimit nga AK. Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në Rregulloren Nr.002/2024 për Plotesimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 50.3 komisioni do të jetë përgjegjës për vlerësimin e ofertave sipas kritereve të përcaktuara dhe negocimin me ofertuesit për të arritur kushtet më të favorshme për AK. I gjithë procesi i vlerësimit dhe negocimit do të bëhet vetëm përmes platformës së prokurimit elektronik. Në rastë specifike, negocijimi mund të bëhet në formë fizike dhe procesverbali ngarkohet në platform.

Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në nenin 50.7 sqaron se ky aktivitet i prokurimit nuk konsiderohet rast specifik. 50.7 Kur ekziston vetëm një furnizues dhe mund të përdoret vetëm nën rrethanat specifike të përcaktuara me nenin 35 të LPP-së si dhe kur nuk ka alternativë, sepse vetëm një operator Ekonomik mund t’i përmbushë kërkesat (psh për arsye të detyrueshme teknike apo të pronës intelektuale), atëherë Autoriteti Kontraktues duhet: a. luaj rol aktiv në përcaktimin

e termave të kontrates, duke iu referuar posaçërisht çmimit, afateve të dorëzimit, sasive, karakteristikave teknike si dhe garancive; b. të siguroj se çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se sa çmimi i tregut në fjalë, dhe c. me kujdes ta vlerësoj cilësinë e produktit, shërbimeve apo punëve në fjalë. Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në udhëzues nr. 002/2024, për plotesim ndryshimin e udhëzuesit nr. 001/2023 për prokurimin public pika 2.82.8 Zgjatja/ndryshimi i dates për Mbyllje/ Afatit për dorëzimin e ofertave në procedurë të kufizuar, konkurruese me negociatë (faza e dyte), të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe minitender, bëhet nëpërmjet ri-krijimit dhe ri-dërgimit të ftesave të OE pjesëmarrës. Në sqarim të nenit 2.8 AK-QKUK është dashur që përmes Platofres E-Prokurimi të ri-dergoj ftesat OE pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi gjë që nuk e ka bërë dhe Autoriteti kontraktues ka zhvilluar negociatat për ulje të çmimit në menyrë fizike. Sa i përket pretendimit të OE ankuse se AK nuk ka promovuar transparence dhe barazi, sepse komisioni gjatë fazës së negociatave, ka krijuar pyetje tendencioze duke na pyetur dhe konstatuar nësi AK nëfazën e negociimit, se jemi të interesuar vetëm çmimin me të ulët, gjë që konsiderojmë që qysh nga fillimi i procesit, komisioni dhe personat përgjegjës, përmes formave të ndryshme kanë diskriminuar OE ofertues, në përfitim të kontrates për OE nëfjale. Ekspertja sqaron se kërkesa për ulje të çmimit e ligjshme dhe e pritshme në këtë lloj procedure duke ia ofruar mundësinë Autoritetit kontraktues të përfitoj realisht nga konkurrenca ndërmjet OE të ftuar për negociim, por duhet të aplikohet në menyrë të njëjtë për të gjithë OE dhe përmes platforms elektronike në menyrë që të respektohet neni 49.21 dhe 50.3 Rregullores për prokurim publik.

49.21 Autoriteti kontraktues do ta dokumentojë në tërësi çdo fazë të negociatave, duke raportuar në veçanti: objektin e negociatave, metodat e përdorura, dhe të gjitha komunikimet verbale dhe me shkrim të mbajtura me pjesëmarrësit. Formulari standard, që ndodhet në ueb faqen e krpp-së, do të përdoret për proces-mbajtjen e negociatave të mbajtur veçmas me secilin pjesëmarrës.

Ekspertja shqyrtuese me datë 18.04.2025 ka kërkuar sqarim në AK-QKUK procesverbalin e negociatave dhe të gjitha dokumentet fizike në këtë aktivitet të prokurimit por nuk me është përcjellur nga na e AK-QKUK.

Me datë: 23.04.2025 me janë përcjelle vetëm Lista çmimeve me ulje të çmimeve me nënshkrime të OE-ik për 7 OE të cilët kanë ofruar çmimin me ulje dhe disa dokumente të cilat janë edhe në platforme elektronike por jo ndonjë dokument fizik mbi të cilin do të kishte pasur mundësinë e përgjigjejes se këtij pretendimi me saktësisht duke u bazuar në procesverbalin e negociatave.

Ekspertja sqaron se sa i përket pretendimit të OE është pjesërisht i bazuar.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 2 Neni 27 dosja e tenderit Eksperti shqyrtues konstaton se në kuader të kriterëve në dosjen e tenderit nuk ka qenë kriteri dorëzimi i analizës financiare në rast të tilla kur kërkohen analiza të tilla financiare duhet vetë autoriteti kontraktues të i saktësoj se cilat elemente pozicionë të shpenzimeve duhet të përfshihen në analizën financiare dhe të paraqes formë të tilla në formën excel të bazuara në ligjin e punës dhe ligjin mbi procedurat e administratës tatimore dhe atëherë të mbetet vetëm ta plotësojnë operatorë ekonomik. Autoriteti kontraktues ka paraqitur të dhënat tek Specifikat teknike në dosje të tenderit dhe ka kërkuar që të deklarojnë OE se do të përmbushin këto specifikat dhe pagën bruto 402 €. Po ashtu tek Aneksi I në Dosje të tenderit AK-QKUK ka kërkuar se shërbimet duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të detyrueshme sipas kriterëve, dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet të cekura si: numrin e vendrojave, punëtorët e sigurimit, dokumentacioni, mjetet dhe udhëzimet

tjera. Ekspertja shqyrtues thekson se sidoqoftë pavarësisht nga përgatitjet e analizave financiare nga ofertuesit, kërkesat e zbatimit të ligjit të punës dhe të ligjit mbi procedurat e administrates tatimore në Kosovë në bazë të ligjeve në fuqi janë obligime ligjore, të mbikëqyrjes nga inspektoratet përkatëse të ATK-së, Inspektoriati i punës dhe të gjitha organeve kompetentë të cilat duhe të zbatojnë ligjet në fuqi. Ekspertja sqaron se sa i perket pretendimit të OE ankues, është i pabazuar

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 3 Operatori ekonomik tek shkelja 3 si thekson si vijon: AK po ashtu është në kundërshtim me Neni 28 LPP-se - Specifikimet teknike sepse kërkesat e DT aneksi I Specifikimet teknike të detyrueshme po shkelen me veprimin për shpërblimin e OE fitues, i cili është i pa përgjegjshëm nuk përmbush kërkesën e pagës 402.00€ bruto bazë dhe kërkesat e ligjit të punës siq janë kërkuar në neksin I. Ekspertja duke analizuar kriterin e vendosur në dosje të tenderit : Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare Kërkesa 1. OE duhet të ofroj një deklartatë me shkrim për realizimin e projektit sipas specifikimeve teknike. Dëshmia 1. OE duhet të paraqesë një deklaratë të shkruar që është në përputhje të plotë me kërkesat e specifikimeve teknike të detyrueshme. Kërkesa 2. Deklaratë me shkrim e nënshkruar nga Ofertuesi për pagën bruto bazë për punëtorët në këtë projekt të jetë 402 € bruto. Evidenca 2. Ofertuesi duhet të japë një deklaratë me shkrim se kompensimi i të ardhurave mujore (Paga bruto bazë) për punëtorë do të jetë 402 € bruto. Sipas Ekspertes OE ka nënshkruar deklaratë mbi specifikat teknike në Aneksin 1 dhe Deklaratë mbi pagën 402,00€ e cila është një bazë për përmbushjen e kontratës pasi që këto kërkesa janë pjesë e kriterëve, OE obligohet në bazë të deklaratës së nënshkruar të paguaj puntoret me page bruto 402 € gjatë përmbushjës (implementimi) të kontratës. Ekspertja konstaton se ky pretendim është I pabazuar.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 4 Neni 31 ekzekutimi i kontratave Sipas OE ankues AK ka vepruar me shpërblimin me kontratë për OE që nuk respekton ligjin e punës dhe kjo kontratë rezulton në dëm të punëtorëve, AK po Shkel nenin 31 të LPP-se. Ekspertja shqyrtuese sqaron, sipas nenit 65 i Ligjit për prokurim publik, OE fitues ka nënshkruar Deklaratën nën betim dhe ka dorëzuar me oferte, përveq tjerash ka nënshkruar deklaratën mbi përmbushjen e pages dhe Specifikimeve teknike për të cilat është deklaruar edhe gjatë procesit të negociatave (bazuar në përgjigjejen e AK në refuzim të kërkesës për Rishqyrtim) dhe këto dëshmi për AK-QKUK kanë qenë bindese për të mos përjashtuar për mos respektim të Ligjit të punës dhe pages për punëtorët. Në rast të mos respektimit (mos përmbushjës) së kontratës AK duhet të marrë masë për shpërblimin e Kontrates dhe Konfiskimin e Sigurimit të ekzekutimit dhe hapat tjerë ligjor. Poashtu për të garantuar të drejtat e punëtorëve është e domosdoshme që Organet kompetentë duhet të ushtrorjnë rolin mbikqyrës dhe të marrin masë adekuate, ndersa sa i perket pretendimit rreth nënshkrimit të kontratës përgjigjejen e gjeni në pretendimit 9. Ekspertja konstaton se ky pretendim është I pa bazuar.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 5 Neni 51 njoftimii i kriterëve të përzgjedhjeve Ekspertja shqyrtuese gjatë verifikimit të kriterëve, nenin 51 pika 3. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes sidhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevantë dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse, duke u bazuar në këtë konstaton se Autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit ka parashtruar kërkesa të cilat sipas mendimit të Ekspertes janë në harmoni me nenet 65-70 të LPP-së dhe si i tillë ky pretendim është I pa bazuar. Ky pretendim sipas mendimit të ekspertës është I pabazuar.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 6Neni 52 Njoftimi i Kritereve të dhënjëPretendime në lidhje me Neni 52 I LPP-së Njoftimi i kritereve për dhënien e kontrates1. Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontrates dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontrates. Kriteret duhet të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm.Ekspertja sqaron se AK –QKUK në këtë aktivitet të prokurimit ka përdorur kriterin e dhenjes çmimi me i ulët duke shpërblyer me kontratë OE”Skyfterat live “ ka respektuar kriterin me çmim me të ulët pas negocimit me qenese kemi të bëjme me PNPJNK.(Duke u bazuar në Raprotin e vlerësimit I nenshkruar nga Komisioni I vlerësimit dhe Vendimi I AK-së).Pretendimi ankimor si i tillë është i paqendrueshëm.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 7Neni 56 Dispozitat e Përgjithhme mbi Përzgjedhjen e Pjesemaresve dhe Dhënien e Kontratave paragrafi 2Ekspertja shqyrtuese konstaton se neni 56 pika 2 konkretisht ka të bëj me refuzimin /zgjedhjen e kandidateve në rastin e procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata të cilët kanë plotësuar kriteret e specifikuar në mënyrë që të ftohen për të dorëzuar tender. Ky nen nuk ka të bëj me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë e cila është përdorur në këtë aktivitet të prokurimit sipas nenit 35.2.1 (iii) të LPP-së ku nuk ka pasur Njoftim për kontratë dhe rrejdimitsh pretendimi I OE ankues nuk qendron për të gjitha arsyet e mesiperme.Pretendimi ankimor sipas Ekspertes shqyrtuese nuk qendron.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 9Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeveOperatori ekonomik “Security Code”- Prishtinë në lidhje me pretendimin e tij për mos pezullim të aktivitetit të prokurimit nga ana e ZPP dhe shkeljeve të neni 108/A,109,59 të LPP-së dhe hapat e ngutshem nga ana e Autoritetit kontraktues –QKUK në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi Fizik i Objekteve brenda-QKUK-së” me numër identifikues: 701-25- 1774-2-1-5, numri i brendshëm: 701-25-047-215:Ekspertes shqyrtuese sqaron se janë të bazuara duke iu referuar dispozitve ligjore:Ligji nr. 04/l-042 për prokurimin publik të republikës së kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me lgjin nr. 04/l-237, ligjin nr. 05/l-068 dhe ligjin nr. 05/l-092, Rregullore Nr.002/2024 për Plotesimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Udhëzues 002 2024 për plotesim ndryshim të Udhëzuesit 001 2023 për prokurimin Publik si vijon;Në procedurat pa publikim të njoftimit për kontrate, Operatorët ekonomik kanë të drejtë për tu ankuar për vendime sipas Nenit 108/A paragrafi 1 dhe 2 citoj:

1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërliken me njoftimet për kontrate, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkates të prokurimit.

2. Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkates kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar.

Neni 109 - Afatet për Dorëzimin e Ankesës1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetem pas udhëheqjes së një procedure

paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. 2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) diteve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Neni 26 Nënshkrimi i kontratave publike⁴. Personat e autorizuar që të nënshkruajnë sipas paragrafit 1. dhe 2. ose 3. të këtij neni mund të nënshkruajnë kontratën e tillë vetëm nëse përmbushen kushtet vijuese:

4.1 Së paku dhjetë (10) ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës; me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit 35.2.1 (iii). Apo për një aktivitet të prokurimit të bazuar në nenin 36. Apo për kontrata me vlerë minimale;

Ekspertja shqyrtuese bazuar në nenet e lartëcekura konstaton se Autoritetit kontraktues Qendra klinike universitare:

-Ka nënshkruar kontratë OE " SKYFTERAT - LIVE " SH.P.K në kundërshtim me nenin 132 pika 1.21,2 është përfunduar gjatë periudhës së pritjes sipas neni 26 të këtij ligji apo gjatë periudhës së vënies së ndonjë mase të përkohshme të urdhëruar nga OSHP ose një gjykatë që ndalon përmbylljen e kontratës-nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit;-ka nënshkruar kontratë pastaj ka publikuar Njoftimin për dhënje;-ka nënshkruar kontratë në periudhën e pritjes , pas pranimit të kërkesës për Rishqyrtim, ka zhvilluar negociatat në mënyrë fizike me operatorët ekonomik, nuk e ka ngakuar në platform procesverbalin e negociatave.

Ekspertja shqyrtuese në bazë të argumenteve të paraqitura dhe dispozitave ligjore të përmendura konstaton se pretendimi i Operatorit ekonomik "Security Code"- Prishtinë është i bazuar.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "BESA SECURITY" SH.P.K Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0230 ka vlerësuar se:

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMEVE ANKIMORE OE "BESA SECURITY"- PRISHTINË

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT I Neni 1 i LPP– Qëllimi Ekspertja shqyrtuese sqaron si vijon një pasqyre të procedurës së ndjekur, me qenëse ky aktivitet të prokurimit ka rezultuar me nënshkrim të kontratës për të japur përgjigjeje pretendimit 1, të OE ankues "Besa Security" në lidhje me shkeljet e Autoritetit kontraktues rreth Neni: Neni 1 i LPP– Qëllimi, Neni 35 i LPP, dheneni 48 i Rregullores së Prokurimit Publik dhe publikimi I dy njoftimeve për dhënje. Ekspertja shqyrtuese duke analizuar të gjitha provat dhe argumentet në dispozicion sqaron: Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka zhvilluar një procedurë të hapur "Sigurimi Fizik i Objekteve brenda-QKUK-së" e cila është anuluar nga AK-QKUK dhe me Vendim të OSHP-se. dhe me rastin e inicimit të procedure së negociuar gjendej në fazën e rivlerësimit nga dt: 13.01.2025.

AK-QKUK ka ndërmarrë hapat për zhvillimin e një procedure të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, "Sigurimi Fizik i Objekteve brenda-QKUK-së" në përputhje me nenin 35,2,(iii) të Ligjit për Prokurimin Publik,

AK-QKUK permes B50 Njofton KRPP për përdorimin e Procedures të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me dt. 12.03.2025 përpjes E-prokurimit.

AK-QKUK ka arsyetuar përdorimin e kësaj procedure duke u bazuar në nenin 35.2.1(iii) pasi që ka zhvilluar procedure të hapur –Ritender për këtë aktivitet me nr.701-24-138-211 I cili me vendim të OShP-se është kthyer në rivleresim por meqenese kontrata sakdon me 20.03.2025 me qellim që mos rrezikohet kontinuiteti i shërbimeve për pacient QKUK e shih të domosdoshme që të mos nderpriten shërbimet. AK-QKUK ka vazhduar me zhvillimin e proceurës edhe pse KRPP brenda afatit kohor ligjor kishe dhënë Opinion për QKUK se Aktiviteti i prokurimit me Nr. 701-25-1774-2-1-5 nuk është në pajtim me nenin 35.2.1 (iii), shih Opinionin e KRPP dhe Njoftimet e publikuara: Vlera e përgjithshme e kontrates 743,047.92 EUR Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët: 743,047.92 Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lartë: 1,042,079.42 Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në të dhënat e me sipërme dhe Ligji nr. 04/l-042 për prokurimin publik të republikës së kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me lgjin nr. 04/l-237, ligjin nr. 05/l-068 dhe ligjin nr. 05/l-092, Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Udhëzues 002 2024 për plotësim ndryshim të Udhëzuesit 001 2023 për prokurimin Publik, pretendimi I OE "Besa Security" se Autoriteti Kontraktues (AK) ka zbatuar procedurën e negociuar pa publikim, duke u bazuar në arsyetimin e emergjencës sipas nenit 35.1 (iii) të LPP-së, përdorimi i kësaj procedure është i lejueshëm vetëm në rastë të caktuar, përfshirë rastet kur situata emergjentë ka ardhur si pasojë e ngjarjeve objektivisht të verifikueshme dhe të paparashikueshme nga autoriteti kontraktues. Për më tepër, neni 35.1 (iiii) thekson se kjo dispozitë nuk mund të zbatohet nëse rrethanat emergjentë janë rezultat i veprimeve neglizhente, të qëllimshme apo mosveprimeve të autoritetit kontraktues siç ka ndodhur në këtë rast. Eksperti shqyrtues sqaron se, lidhur me pretendimin se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me nenin 35 të LPP-se kur AK ka zhvilluar procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë për aktivitetin të prokurimit me titull "Sigurimi Fizik i Objekteve brenda-QKUK-së" me numër identifikues: 701-25- 1774-2-1-5, numri i brendshëm: 701-25-047-215, sipas ekspertës pretendimi është I bazuar. Kjo për faktin se nuk janë plotësuar kriteret e parapara në nenin 35 të LPP-së për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit publik në fjalë përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë por si rezultat I faktorit njeri. Sipas Ekspertes shqyrtuese praktikat e tilla ndikojnë në uljen e transparencës dhe besueshmërisë në prokurim publik. Duke u marrë për bazë Opinioni e KRPP-së Autoriteti kontraktues -QKUK nuk ka marrë për bazë Vendimi i OSHP-se i lëshuar me datë 13.01.2025, rezulton se AK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-se (Anulimin e anulimit të procedurës), si dhe vlerësimin e tenderëve sipas Legjislacionit për Prokurimin Publik i cili duhet të përfundojë brenda 30 diteve dhe në rastë t jashtëzakonshme dhe të arsyetuara një afat shtese prej 20 ditë shtese sipas nenit 40, paragrafi 3 të Rregullave për Prokurim Publik. Këto veprime kanë ardhur si rezultat i veprimeve neglizhente (faktorit njeri) apo mosveprimeve të autoritetit kontraktues. Si përfundim Emergjencat Ekstreme janë të rregulluara me nenin 48.3 të Rregullave për Prokurim Publik i cili specifikon se bazë emergjentë do të thote; a) Domosdoshmëri strikte e zhvillimit të një aktiviteti prokurimi në baza emergjente, b) Motivuar nga ngjarje të verifikueshme në mënyrë objektive që nuk ishin të parashikueshme nga autoriteti kontraktues c) Nuk mund t'i arrij afatet kohore të kërkuara dhe d) Rrethanat emergjentë nuk i atribuohen veprimeve neglizhente apo të qëllimshme, ose mosveprimeve të autoritetit kontraktues. Vlen të përmendet se sipas KRPP-së, është hera e tretë që inicohet Procedura se Negociuar pa Publikim të Njoftimit, përfshirë dhe këtë numër të

prokurimit/procedurës, KRPP ka lëshuar dy OPINIONË rreth arsyeshmërisë së përdorimit të Procedurave të Negociuara pa Publikim nga AK: “QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES”.. Kjo vonesë mund të interpretohet si neglizhencë e AK-së.

Ekspertja shqyrtues thekson se Opinioni I KRPP nuk ka karakter detyrues për Autoritet kontraktues por mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të Autoritetit kontraktues respektivisht të zyrtarit përgjegjës të prokurimit që të zhvillohen procedurat e prokurimit konform LPPsë në mënyrë që të lejohet trajtimi i barabartë dhe konkurrenca sa më të gjerë në mënyrë që të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për paranë dhe Transparenca dhe trajtimi I barabartë.

Ekspertja shqyrtuese vazhdon tutje në shtjellim të pretendimeve rreth Vendimeve të publikuara në Platformë me vlera të ndryshme 748,047.92 euro, ndërsa në atë të dates 25.03.2025 me 743,047.92 euro dhe kjo ngrit shqetësime në lidhje me saktësinë dhe qëndrueshmërinë e të dhënave të publikuara në Vendimet e AK, tek Operatorët ekonomik për me teper pasi ka qenë me Procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontrat

Deshmi versionet nga Platforma -Vendime të AK-s

2. B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK.pdf Shqip Hapeni dokumentin e krijuar
24.03.2025. 12:24 çmimi 743,047.92 €

1. B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK.pdf Shqip Hapeni dokumentin e krijuar
20.03.2025. 21:33 çmimi 748,047.92 €

Ekspertja shqyrtuese sqaron se pretendimi ankimor është i bazuar.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 2Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në Rregullore Nr.002/2024 për Plotesimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin PublikNeni 50.3 Komisioni do të jetë përgjegjës për vlerësimin e ofertave sipas kriterëve të përcaktuara dhe negocimin me ofertuesit për të arritur kushtet më të favorshme për AK. I gjithë procesi i vlerësimit dhe negocimit do të bëhet vetëm përmes platformës së prokurimit elektronik. në rastë specifike, negocijimi mund të bëhet në formë fizike dhe procesverbali ngarkohet në platformë

Ekspertja shqyrtuese me tej duke u bazuar në nenin 50.7 ky aktivitet I prokurimit nuk konsiderohet rast specifik për të zhvilluar negociatat në mënyrë fizike shih neni:50.7 Kur ekziston vetëm një furnizues dhe mund të përdoret vetëm nën rrethanat specifike të përcaktuara me nenin 35 të LPP-së si dhe kur nuk ka alternativë, sepse vetëm një operator Ekonomik mund t'i përmbush kërkesat (psh për arsye të detyrueshme teknike apo të pronës intelektuale), atëherë Autoriteti Kontraktues duhet:a.luaj rol aktiv në përcaktimin e termave të kontrates, duke iu referuar posaçërisht çmimit, afateve të dorëzimit, sasive, karakteristikave teknike si dhe garancive;b. të siguroj se çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se sa çmimi i tregut në fjalë, dhec. me kujdes ta vlerësoj cilësinë e produktit, shërbimeve apo punëve në fjalë.Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në udhëzues nr. 002/2024, për plotesim ndryshimin e udhëzuesit nr. 001/2023 për prokurimin public pika2.8 Zgjatja/ndryshimi i dates për Mbyllje/ Afatit per dorezimin e ofertave në procedurë të kufizuar, konkurruese me negociata (faza e dyte), të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe minitender, bëhet nëpërmjet ri-krijimit dhe ri-dërgimit të ftesave të OE pjesëmarrësNë sqarim të nenit 2.8 AK-QKUK është dashur që përmes Platofrës E-Prokurmi të ri-dergoj ftesat OE pjesëmarrës në këtë procedure prokurmi gjë

që nuk e ka bërë dhe Autoriteti kontraktues ka zhvilluar negociatat dhe ofertat e ofruar për ulje të çmimit në menyrë fizike. Ndërsa sa I përket tabelës me çmime të ofertave në procesverbalin e hapjes dhe pas negociimit Ekspertja shqyrtuese sqaron se OE "Skyfterat-Live" kanë nënshkruar Kontratë me çmim pas negociimit prej 743,047.92 € dhe jo me çmimin të dhënë 748,047.92 € në tabelën tuaj. Në mungesë të procesverbalit të hapjes nuk mund të jap përgjigjeje në lidhje me dy çmime të ndryshme nga ana e AK-së në dy Njoftim për dhënie dhe arsyen e ndryshimeve. Pretendimi ankimor sipas Ekspertes shqyrtuese është I bazuar.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 3 Neni 7 i LPP – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Sipas Ekspertes OE ka nënshkruar deklaratë mbi specifikat teknike në Aneksin I në dosje të tenderit dhe Deklaratë mbi përmbushjen e pagës 402,00€ e cila është një bazë për përmbushjen e kontratës pasi që keto kërkesa janë pjesë e kritereve që pas nënshkrimit deklaratave Operatori ekonomik obligohet në bazë të deklaratës së nënshkruar të paguaj puntoret me pagë bruto 402 € gjatë përmbushjës (implementimi) të kontratës. Ekspertja konstaton se ky pretendim është I pabazuar

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 4 Neni 42 i LPP - Publikimi i njoftimeve Në lidhje me pretendimin rreth Njoftimit për nënshkrim të kontratës I Publikuar 27.03.2025. AK-QKUK në këtë aktivitet të prokurimit nuk është publikuar 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Ekspertja shqyrtuese sqaron se Kontrata është nënshkruar me datë 21.03.2025 dhe Njoftimi për nënshkrim është bërë me 27.03.2025 që I bie 5 ditë pas Nënshkrimit të kontratës. Pretendim është I bazuar sipas Ekspertes shqyrtuese

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 5 Neni 59 i LPP – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve Ekspertja shqyrtuese konstaton se në kuadër të kritereve në dosjen e tenderit nuk ka qenë kriter dorëzimi i analizës financiare në rastë të tilla kur kërkohen analiza të tilla financiare duhet vetë autoriteti kontraktues të i saktesoj se cilat elementë pozicionë të shpenzimeve duhet të përfshihen në analizën financiare dhe të paraqes formë të tilla në formën excel të bazuar në Ligjin e punës dhe Ligjin mbi procedurat e administratës tatimore dhe Ligjet e tjera në fuqi vatesisht nga natyra e aktivitetit të prokurimit atëherë të mbetet vetëm ta plotësojnë operatorët ekonomik.

Sidoqoftë pavarësisht analiza financiare nuk ka qenë kriter I vlerësimit tek Aneksi I, kanë qenë specifikat teknike të detyrueshme përmes deklaratave tek kriteret por edhe në këto rastë të analizave financiare nga ofertuesit kërkesat e zbatimit të ligjit të punës dhe të ligjit mbi procedurat e administratës tatimore nëkosovë në bazë të ligjeve në fuqi janë obligime ligjore të mbikëqyrjes nga inspektoratet përkatëse të ATK-së, Inspektorati i punës dhe të gjitha orgnet kompetentë duhet të zbatohen në harmoni me ligjet në fuqi po ashtu edhe të Autoritetit kontraktues Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pabazuar

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 6 Neni 61 i LPP - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Sa I përket pretendimit se OE fitues është i pa përgjegjshëm nuk përmbush kërkesën e pagës 402.00€ bruto bazë dhe kërkesat e ligjit të punës siq janë kërkuar në aneksin I. Ekspertja duke analizuar kriterin e vendosur në dosje të tenderit :Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare Kërkesa 1. OE duhet të ofroj një deklaratë me shkrim për realizimin e projektit sipas specifikimeve teknike. Dëshmia 1. OE duhet të paraqesë një deklaratë të shkruar që është në përputhje të plotë me kërkesat e specifikimeve teknike të detyrueshme. Kërkesa 2. Deklaratë me shkrim e nënshkruar nga Ofertuesi për pagën bruto bazë për punëtorët në këtë projekt të jetë 402

€ bruto. Evidenca 2. Ofertuesi duhet të japë një deklaratë me shkrim se kompensimi i të ardhurave mujore (Paga bruto bazë) për punëtorë do të jetë 402 € bruto sipas Ekspertes OE ka nënshkruar deklaratë mbi specifikat teknike në Aneksin 1 dhe Deklaratë mbi pagën 402,00€ e cila është një bazë për përmbushjen e kontrates pasi që keto kërkesa janë pjesë e kriterëve OE obligohet në bazë të deklaratës së nënshkruar të paguaj puntoret me pagë bruto 402 € gjatë përmbushjës (implementimi) të kontrates. Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pabazuar.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 7 Neni 132 i LPP - Prokurimet e Mbyllura në Kundërshtim me Këtë Ligj Ekspertja shqyrtuese duke iu referuar pretendimit ankimor në lidhje me shkëlqen nga ana e AK-së të nenit 132 i LPP dhe duke pritur për një periudhë prej katër muajsh dhe duke e justifikuar këtë vonesë përmes përdorimit të procedurës së negociuar për shkak të emergjencës sqaron: Neni 132 i LPP përcakton se “Kontrata publike ose konkursi i projektimit mund të shfuqizohet pjesërisht ose plotësisht nga OSHP ose një gjykatë, nëse të përmendurit konstatojnë se kontrata publike ose konkursi i projektimit: 1.1. është dhënë pa publikimin e mëhershëm të njoftimit kur është kërkuar nga ky ligj; 1.2. është përfunduar gjatë periudhës së pritjes sipas neni 26 të këtij ligji apo gjatë periudhës së vënies së ndonjë mase të përkohshme të urdhëruar nga OSHP ose një gjykatë që ndalon përmbylljen e kontrates. AK nuk ka respektuar periudhën e pritjes për ankesa, duke vijuar me nënshkrimin e kontrates pa bërë publikimin e njoftimit për dhenje si rrjedhojë dhe nuk ka respektuar periudhën e pritjes rrjedhimisht sipas mendimit të ekspertës shqyrtuese përmbushen dy kushtet e nenit 132 të LPP. • Neni 132.1.1: Mosrespektimi i kërkesës për publikimin e mëhershëm të njoftimit; • Neni 132.1.2: Nënshkrimi i kontrates gjatë periudhës së pritjes. Ekspertja shqyrtuese bazuar në sqarimin me lartë pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor nga ana e Operatorit ekonomik “Besa Security” lidhur me kërkesën ndaj OSHP dhe Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP) për marrjen e certifikatës së Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit (ZPP), në përputhje me nenin 97 të Rregullores së Prokurimit Publik, pika “m”. Ekspertja shqyrtuese sqaron se Zyrtari përgjegjës i prokurimit ka përdorur procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë duke e trajtuar si emergjentë dhe bindja e tij ka qenë se është duke vepruar drejt në përdorimin e saj, në këtë kontekst pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 8 Neni 42.2 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotesimin dhe Ndryshimin e Rregullik 61.3 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotesimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Ekspertja shqyrtuese në përputhje me nenin 42.2 të Rregullores së Prokurimit Publik, në procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ku OE ankues ka paraqitur pretendimet e tij në lidhje me mospublikimet e Formularin B58 – “Njoftimin mbi Vendimin e AK” dhe Formularin B08 – “Njoftimin për Dhënie të Kontrates” sipas Nenit 42.2 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotesimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik ku QKUK ka ngritur “Njoftimin mbi Vendimin dhe AK vazhduar me nënshkrimin e kontrates pa pritur afatin ligjor për paraqitjen e ankesave. Ekspertja shqyrtuese këtë pretendim e ka sqaruar me gjerësisht edhe në përgjigjejet ndaj pretendimeve tjera në këtë ankesë megjithatë ky pretendim qendron. Sa i përket pretendimit ankimor në lidhje me nenin 61.3 të Rregullores së Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktues, përkatesisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, është i detyruar të publikojë Kërkesën për Rishqyrtim në Platformën e Prokurimit Elektronik, tek dosja e tenderit në seksionin “shtet dokument shtesë”. Ekspertja shqyrtuese ka konstatuar se në Platformën elektronike nuk figuron

Kërkesa për rishqyrtim dhe si rrjedhojë ky pretendim është si i bazuar.

Konstatimi I ekspertit -Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE “Security Code”- Prishtinë dhe OE “BESA SECURITY SH.P.K.” të aprovohet si e bazuar, ndërsa Kontrata e nënshkruar nga AK-QKUK të shfuqizohet.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Security Code”, aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Sigurimi Fizik i Objekteve brenda-QKUK-së”, me nr. të prokurimit: 701-25-1774-2-1-5, që të shfuqizohet kontrata e nënshkruar nga AK. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuar, duke sugjeruar që kontrata e nënshkruar nga AK të shfuqizohet.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “BESA SECURITY” SH.P.K. aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Sigurimi Fizik i Objekteve brenda-QKUK-së”, me nr. të prokurimit: 701-25-1774-2-1-5, që të shfuqizohet kontrata e nënshkruar nga AK. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuar, duke sugjeruar që kontrata e nënshkruar nga AK të shfuqizohet.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së

shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES, QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**
- **OE - Security Code, BESA SECURITY SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: